



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
K R Y E S I A

Nr. 292

TIRANE 25.7.2018

Urdhër

Nr. 14 datë 25 korrik 2018

Për organizimin e veprimtarisë “Mbajtje ligjëratash përruese dhe *in honorem* në ceremoninë e ndarjes së çmimeve të konkursit për veprën dhe botimin më të suksesshëm shkencor kushtuar Gjergj Kastriotit - Skënderbeut dhe epokës së tij”, datë 20 shtator 2018

**Për: Kryesinë e Akademisë së Shkencave
Seksionet shkencore të Akademisë
Sektorin e botimeve shkencore dhe bibliotekës shkencore
Sektorin e financës
Sektorin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve
Specialistin e komunikimeve shkencore, marrëdhënieve me jashtë dhe publikun**

Në mbështetje të:

1. Ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*, i ndryshuar;
2. Vendimit nr. 24 datë 2 2.12.2017, *Për shpalljen e konkursit për veprën më të mirë shkencore kushtuar Gjergj Kastriotit - Skënderbeut dhe epokës së tij* ,
3. Përkujtesës së jurisë së këtij konkursi ngritur pranë Akademisë së Shkencave, bashkëlidhur;

Me propozim të Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike (SSHSHA):

1. Të organizohet veprimtaria *Mbajtje ligjëratash përruese dhe in honorem në ceremoninë e ndarjes së çmimeve të konkursit për veprën dhe botimin më të suksesshëm shkencor kushtuar Gjergj Kastriotit - Skënderbeut dhe epokës së tij* më datën 20 shtator 2018, me këtë përmbajtje:

a. Referime të të nominuarve (shqiptarë e të huaj) të konkursit për veprën më të mirë shkencore kushtuar Gjergj Kastriot-Skënderbeut dhe epokës së tij;

b. Referime për studiuesit e propozuar nga juria për vlerësim *in honorem*;

c. Ceremonia e ndarjes së çmimeve të konkursit *Për veprën dhe botimin më të mirë shkencor kushtuar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe epokës së tij*, sipas programit bashkëlidhur.

2. Ngarkohet sektori i financës të marrë masat për mbulimin shpenzimeve sipas programin dhe preventivit të paraqitur, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Për realizimin e këtij urdhri ngarkohen seksionet shkencore dhe sektorët e shërbimeve, sipas përgjegjësisë funksionale.

4. Për njoftimin dhe shpërndarjen e këtij urdhri, si dhe për komunikimin shkresor dhe me shtypin ngarkohet specialisti i komunikimeve shkencore, marrëdhënieve me jashtë e publikun.

5. Për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri ngarkohet kryetari i SSHSHA.

Bashkëngjitur përkujtesa e jurisë së konkursit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI SHKENCOR

Akad. VASIL S. TOLE

